

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

**Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2008**

(dhe raporti i auditorëve të pavarur)

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra përmbledhëse	Faqja
Raporti i auditorëve të pavarur	i - ii
Pasqyrat financiare:	
Bilanci	1
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	2
Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit dhe rezervave	3
Pasqyra e rrjedhjes së parasë	4
Shënime mbi pasqyrat financiare	5-37



KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Telephone +381 38 246 771
Telefax +381 38 246 772
E-mail al-kosovo@kpmg.com
Internet www.kpmg.al

Raporti i audituesve të pavarur

Bordit Drejtues të
Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Prishtinë, 2 qershor 2009

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("Banka"), të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i datës 31 dhjetor 2008, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet dhe pasqyra e flukseve të parave për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe një përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm, mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi; zgjedhjen dhe zbatimin e politikave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

Përgjegjësia e Audituesve

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u bë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të marrim një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare nuk kanë anomali materiale.

Auditimi ka të bëjë me kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimit apo gabimit. Kur vlerëson këto rreziqe, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të entitetit mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare në mënyrë që të planifikojë procedura të përshtatshme auditimi në rrethanat përkatëse të entitetit, por jo me qëllim që të shprehë një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu ka të bëjë me vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.



Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të gjendjes financiare të Bankës më 31 dhjetor 2008, të rezultatit të saj financiar dhe të flukseve të saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Theksimi i Çështjes

Pa dhënë rezervë në opinion, ne tërheqim vëmendjen për shënimin 4(f) të pasqyrave financiare ku cilësohet se sipas Ligjit Nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Kapitali dhe Llogaritë e Rezervave të Përgjithshme duhet të jenë së paku të barasvlershme me pesë për qind të shumës totale të gjendjeve kreditore të të gjitha llogarive të mbajtura në librat e Bankës në fund të çdo viti financiar. Më 31 dhjetor 2008 dhe 2007 kjo kërkesë nuk ishte përmbushur.

KPMG Albania Sh.p.k. Kosovo Branch

KPMG Albania Sh.p.k. - Kosovo Branch
14, Sulejman Vokshi Street
Pristina
Kosovo

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Bilanci

Më 31 dhjetor

<i>Në mijë EUR</i>	Shënime	2008	2007
Aktivët			
Paraja e gatshme	7	39,674	63,817
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	10,403	1,946
Bono thesari	9	541,019	229,277
Depozita me banka jo-vendore	10	519,276	762,579
Prona dhe pajisjet	11	2,087	2,108
Aktivët e paprekshme	12	86	122
Aktive të tjera	13	406	295
Totali i aktiveve		<u>1,112,951</u>	<u>1,060,144</u>
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	137,158	113,554
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	908,212	856,730
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	24,400	48,381
Detyrime të tjera të brendshme	17	1,978	7,743
Totali i detyrimeve		<u>1,071,748</u>	<u>1,026,408</u>
Kapitali dhe rezervat			
Kapitali	18	30,000	20,000
Rezerva të përgjithshme	19	11,203	13,736
Totali i kapitalit dhe rezervave		<u>41,203</u>	<u>33,736</u>
Totali i detyrimeve, kapitalit dhe rezervave		<u>1,112,951</u>	<u>1,060,144</u>


Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare në faqet 1 deri në 37 u miratuan nga menaxhmenti i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës më 4 maj 2009 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Hashim Rexhepi

Guvernator



Gani Gerguri

Zëvendësguvernator

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë EUR</i>	Shënime	2008	2007
Të hyra nga interesi		42,841	34,275
Shpenzimet e interesit		(34,063)	(24,371)
Të hyrat nga interesi neto	20	<u>8,778</u>	<u>9,904</u>
Të hyra nga tarifat dhe komisionet		884	743
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet		(215)	(226)
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet neto	21	<u>669</u>	<u>517</u>
Të hyrat nga grantet	22	85	453
Të hyrat e tjera nga aktivitetet operuese	23	<u>1,087</u>	<u>954</u>
Të hyrat nga aktivitetet operuese		10,619	11,828
Shpenzimet e personelit	24	(1,771)	(1,412)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11,12	(458)	(447)
Shpenzime të përgjithshme dhe administrative	25	<u>(923)</u>	<u>(823)</u>
Shpenzimet operuese		(3,152)	(2,682)
Fitimi për periudhën		<u>7,467</u>	<u>9,146</u>

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit dhe rezervave

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

Në mijë EUR

	Shënime	Kapitali	Rezerva të përgjithshme	Fitime të mbartura	Totali
Gjendja më 1 Janar 2007		10,000	14,590	-	24,590
Fitimi për periudhën		-	-	9,146	9,146
Totali i të hyrave dhe shpenzimeve		-	-	9,146	9,146
Transferime në kapital	18	10,000	(10,000)	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2007		20,000	4,590	9,146	33,736
Gjendja më 1 Janar 2008		20,000	4,590	9,146	33,736
Fitimi për periudhën		-	-	7,467	7,467
Totali i të hyrave dhe shpenzimeve		-	-	7,467	7,467
Transferime në kapital	18	10,000	(854)	(9,146)	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2008		30,000	3,736	7,467	41,203

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor

<i>Në mijë EUR</i>	Shënime	2008	2007
Rrjedhja e parasë nga operacionet			
Fitimi për periudhën		7,467	9,146
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	11	378	353
Amortizimi	12	80	94
Të hyrat nga grantet	17	(85)	(252)
Fitim nga shitja e pajisjeve		(5)	(4)
Të hyra nga interesi	20	(42,841)	(34,275)
Shpenzimet e interesit	20	34,063	24,371
		(943)	(567)
Ndryshime në bono thesari		(145,749)	(117,269)
Ndryshime në depozita me banka jo-vendore		197,908	(182,467)
Ndryshime në aktive të tjera		(111)	(118)
Ndryshime në detyrimet ndaj bankave të brendshme		23,604	19,077
Ndryshime në detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse		51,482	380,909
Ndryshime në detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike		(23,835)	3,305
Ndryshime në detyrime të tjera të brendshme		(5,717)	5,337
		96,639	108,207
Interes i arkëtuar		47,329	29,912
Interes i paguar		(34,209)	(24,371)
Rrjedhja e parasë nga operacionet		109,759	113,748
Rrjedhja e parasë nga investimet			
Shitja e pajisjeve		5	4
Blerja e pajisjeve	11	(357)	(1,199)
Blerja e aktiveve të paprekshme	12	(44)	(72)
Përdorimi i parasë nga investimet		(396)	(1,267)
Rrjedhja e parasë nga financimet			
Grante të marra	17	36	-
Para nga financimet		36	-
Rritja neto në para dhe ekuivalentët e saj		109,399	112,481
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 Janar		621,479	508,998
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	26	730,878	621,479

Shënimet nga faqja 5 deri në faqen 37 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (nga këtu e tutje “BQK”), entitet pasardhës i Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës, është një entitet i pavarur juridik me një kapacitet të plotë si një person legal nën ligjin i cili është i aplikueshëm në Republikën e Kosovës. BQK është një entitet publik i veçantë me autoritetin për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës. Entiteti fillestar paraardhës i BQK-së – Autoriteti Bankar dhe i Pagesave të Kosovës është themeluar në përputhje me dispozitat e Rregullores nr: 1999/20 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (nga këtu e tutje “UNMIK”) të miratuar më 15 nëntor 1999, ndryshuar më 1 tetor 2001 (Rregullorja nr. 2001/24 e UNMIK-ut). Më 24 gusht 2006 një rregullore e re (Rregullorja nr. 2006/47 e UNMIK-ut) hyri në fuqi duke e transformuar Autoritetin Bankar dhe të Pagesave të Kosovës në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës. Më 5 qershor 2008, Ligji nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës u miratua nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Sipas këtij ligji objektivat kryesore të BQK-së janë si vijon:

- të kujdeset për saktësinë, aftësinë e pagimit dhe funksionimin efikas të një sistemi financiar bazuar në një treg të qëndrueshëm, duke inkurajuar krijimin e instrumenteve të sigurta financiare; dhe
- pa ndonjë paragjykim, të përkrahë politikat e përgjithshme ekonomike në Kosovë për të kontribuar në një shpërndarje efektive të burimeve në pajtim me parimet e një tregu të hapur ekonomik.

BQK-ja mes tjerash, ka këto kompetenca të veçanta:

- të rekomandojë një politikë të gjerë udhëzuese për Kuvendin dhe Qeverinë në fushat që janë në përgjegjësinë e saj;
- të formulojë dhe të zbatojë masat, të mbikëqyrë dhe rregullojë sistemet e pagesave për transaksionet në valutë vendore dhe të huaj në Kosovë;
- të posedojë dhe të operojë një ose më shumë sisteme pagesash;
- të veprojë si agjent bankar për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të japë këshilla financiare nëse kërkohet;
- të veprojë si agjent fiskal për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave
- të mbajë depozita në valutë të huaj të bankave, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, si dhe subjekteve tjera publike;
- të sigurojë furnizim të mjaftueshëm të bankënotave dhe monedhave për kryerjen e transaksioneve me para të gatshme;
- të sigurojë një vend depozitimi të sigurt për ruajtjen e monedhave dhe letrave me vlerë;
- të licencojë, mbikëqyrë dhe rregullojë institucionet financiare;
- të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, të publikojë rezultatet dhe të paraqesë propozimet dhe masat Kuvendit dhe Qeverisë në bazë të këtyre analizave;
- të mbikëqyrë dhe rregullojë agjentët e këmbimeve valutore, komisionerët-agjentë, dhe fondet e përbashkëta;
- të aprovojë auditorët e jashtëm të institucioneve financiare; dhe
- të vendosë standardet e kontabilitetit për institucionet financiare në Kosovë në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues (vazhdim)

BQK-ja operon nga zyrat e saj qendrore në Prishtinë. Adresa zyrtare e BQK-së është:

Rruga Garibaldi nr. 33
Prishtinë, Kosovë.

Bordi drejtues

Bordi drejtues formulon politikat operationale të BQK-së dhe mbikëqyr realizimin e tyre. Drejtuesit (menaxhmenti) i BQK-së kërkohet të raportojnë tek Bordi drejtues, jo më pak se dhjetë herë brenda vitit, për zhvillimin e operationeve dhe politikave, për gjendjen e sistemit financiar, për gjendjen e tregut valutor, të parasë dhe kapitalit, duke përfshirë të gjitha ngjarjet dhe kushtet që pritet të kenë ndikime të rëndësishme në administratë, në operatione të BQK-së, në drejtimin e politikave të sistemit financiar ose në tregjet e përmendura më parë dhe në çdo çështje tjetër që ndikon ose mundet të ndikojë politikat e BQK-së.

Bordi drejtues përcakton politikat për operationet e BQK dhe mbikëqyr zbatimin e tyre. Sipas Ligjit nr. 03/L-074, Bordi drejtues përbëhet nga pesë anëtarë. Bordi drejtues ka këto kompetenca:

- të miratojë politikat për ekzekutimin e autoritetit të BQK-së dhe të mbikëqyrë realizimin e tyre nga drejtuesit dhe stafi;
- të miratojë të gjitha rregullat, direktivat dhe udhëzimet e lëshuara nga BQK-ja;
- të miratojë të gjitha raportet dhe rekomandimet që BQK-ja bën për Kuvendin dhe Qeverinë;
- të emërojë me vendim, së paku dy drejtorë jo-ekzekutivë për të formuar Komitetin e auditimit;
- të miratojë organizimin e BQK;
- të miratojë propozimin e Guvernatorit për caktimin e dy Zëvendësguvernatorëve të BQK-së për një periudhë pesëvjeçare;
- të miratojë caktimin e Inspektorit të përgjithshëm të BQK-së për një periudhë pesëvjeçare;
- të miratojë buxhetin e BQK-së;
- të aprovojë politikat kontabël të BQK-së dhe të aprovojë raportimin periodik dhe pasqyrat financiare të BQK-së;
- të vendosë mbi gjendjen e borxhit në shuma materiale nga BQK-ja dhe kushtet dhe afatet e këtij borxhi;
- të aprovojë kategoritë e aktiveve që do të jenë të përshtatshme për investimet e burimeve financiare të BQK-së;
- të miratojë ose refuzojë aplikimet për licencimin dhe regjistrimin e institucioneve financiare dhe të tërheqë licencat ose regjistrimet e institucioneve financiare;
- të adoptojë strukturat e brendshme, politikat dhe procedurat për licencimin, regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e institucioneve financiare, duke përfshirë delegimin e autoritetit tek stafi i BQK për ndërmarrjen e hapave korrigjues; dhe
- të ratifikojë para zbatimit të tyre, të gjitha masat në fuqi të përgatitura nga stafi i BQK-së, me përjashtim të atyre që janë të përcaktuara me ligj nën kompetencën e Guvernatorit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues (vazhdim)

Bordi Drejtues (vazhdim)

Më 31 Dhjetor 2008, Bordi drejtues i BQK-së përbëhej nga këta anëtarë:

Gazmend Luboteni – Kryetar

Hashim Rexhepi – Guvernator

Lulzim Ismajli – Drejtor i Thesarit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Sejdi Rexhepi – Anëtar

2. Bazat e përgatitjes

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”).

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- instrumentet financiare derivative janë matur me vlerë të drejtë
- instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë
- pronat e mbajtura për investim janë matur me vlerë të drejtë
- detyrimet për shlyerjen në mjete monetare të marrëveshjeve për pagesat bazuar në aksione janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet dhe detyrimet financiare të përcaktuara si zëra të mbrojtur në marrëdhëniet e kualifikuara për mbrojtje rregullohen për ndryshimin në vlerën e drejtë që i atribuohet riskut ndaj të cilit po kryhet mbrojtja.

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Pasqyrat financiare prezantohen në euro (“EUR”), e cila është monedha funksionale e BQK-së. Nëse nuk është shënuar ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në euro është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtimi (menaxhmenti) që të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen vazhdimisht. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen. Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe mbi gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efekt të konsiderueshëm në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në shënimin 5.

Politikat kontabël të përshkruara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat të prezantuara në këto pasqyra financiare.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël

a) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit. Fitimi apo humbja nga kursi i këmbimit për zërat monetarë është diferenca ndërmjet kostove të amortizuara në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostove të amortizuara në monedhë të huaj të konvertuara me kursin e këmbimit në fund të periudhës. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj që maten me vlerë të drejtë konvertohen në monedhë funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është vendosur vlera e drejtë. Diferencat nga kursi i këmbimit që rrjedhin nga konvertimi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

BQK-ja vepron kryesisht në euro, ndërsa në valutë të huaj BQK vepron kryesisht në dollarin amerikan (USD). Kurset zyrtare të këmbimit të përdorura për konvertim më 31 Dhjetor 2008 dhe 2007 paraqiten si më poshtë:

	2008 EUR	2007 EUR
1 USD	0.718	0.679

b) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave bazuar në metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së aktivitet ose detyrimit financiar (ose një periudhë më e shkurtër kur është e përshtatshme) deri në vlerën kontabël të aktivitet ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktivitet ose detyrimit financiar dhe nuk rishikohet më pas.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet a paguara apo të arkëtuara, kostot e transaksioneve, dhe zbritjet apo primet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit.

Kostot e transaksioneve përfshijnë kosto shtesë të ngarkueshme drejtpërdrejt për blerjen apo emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave përfshijnë interesat nga aktivitet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

c) Tarifa dhe komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, përfshirë tarifat e transaksioneve për llogaritë operative, transferimet e fondeve dhe tarifat e licencimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve të lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël

d) Përfitimet e punonjësve

i. Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

BQK-ja paguan kontributet për sigurimet shoqërore të detyrueshme që përcaktojnë përfitimet e punonjësve kur dalin në pension. Autoritetet vendore janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar. Kontributet e BQK-së njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

Gjithashtu, BQK-ja njih kontribute të përcaktuara të pagueshme në fonde pensionesh të jashtëm. Norma e kontributeve shtesë është 10% e pagës bruto. Këto shuma njihen si shpenzime kur ato ndodhin. BQK-ja nuk ka ndonjë detyrim ligjor apo të tërthortë të paguajë kontribute të tjera.

ii. Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve maten mbi baza të pazbritshme dhe shpenzohen kur shërbimi kryhet.

e) Tatimi dhe shpërndarja e fitimit

BQK-ja është e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin sipas Ligjit nr. 03/L-074 miratuar më 5 qershor 2008, i cili kërkon që BQK të paguajë tepicën e të ardhurave neto direkt në llogarinë e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, pasi të ketë plotësuar nivelet e fondit rezervë (shiko shënimin 4 f)

f) Aktivitet dhe detyrimet financiare

i. Njohja

BQK-ja fillimisht njih depozitat në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivitet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën BQK bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

ii. Mosnjohja

BQK-ja nuk njih një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktivitet financiar mbarojnë, ose kur ajo i transferon të drejtën kontraktuale për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivitet financiar një pale tjetër, pa mbajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet e pronësisë të aktivitet financiar. Interesa nga aktivitet financiare të transferuara që përfitohet ose mbahet nga BQK-ja njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

BQK-ja nuk njih një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

iii. Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në bilanc atëherë dhe vetëm atëherë kur BQK-ja ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivitetin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

f) Aktivitet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

iv. Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi financiar matet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo diference ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

v. Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së një aktivi ose detyrimi financiar është vendosur duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të vlerës aktuale, analizat e fluksit monetar të skontuar, krahasime me instrumente të tjera të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmime tregu lehtësisht të vëzhgueshme, dhe modele vlerësimi. BQK-ja përdor modele vlerësimi të njohura gjerësisht për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve më të zakonshme dhe të thjeshtë. Për këto instrumente financiare, të dhënat në modele janë të vëzhgueshme nga tregu.

vi. Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë bilanci, BQK-ja vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen nëse evidencë objektive tregon se një ngjarje zhvlerësimi ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe që ngjarja e zhvlerësimit ka një ndikim në flukset e ardhshme të mjeteve monetare të aktivitetit, të cilat mund të maten me besueshmëri

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa ose vështirësi financiare të huamarrësit, ristrukturimin e një depozite apo paradhënie nga BQK-ja me kushte dhe afate të cilat BQK-ja nuk do t'i kishte konsideruar, të dhëna që një huamarrës ose emetues i letrave me vlerë po falimenton, zhdukja e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si p.sh ndryshime të pafavorshme në aftësinë paguese të një huamarrësi ose emetuesi të letrave me vlerë, ose kushte ekonomike që lidhen me sjelljen e vështirësive financiare në BQK.

Humbja nga zhvlerësimi i një aktivi financiar të matur me koston e amortizuar është llogaritur si diferencë ndërmjet vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare skontuar me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe paradhënieve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuara vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme.

Kur një ngjarje pas datës së bilancit tregon për zvogëlim të zhvlerësimit, zhvlerësimi anulohet nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

g) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë, llogari rrjedhëse me bankat dhe të tjera aktive financiare afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë, dhe përdoren nga BQK-ja në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

h) Letra me vlerë

Letrat me vlerë që mbahen për investim njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus kosto të tjera direkte të transaksionit, dhe në vijim mbahen si ato deri në maturim.

i. Të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë aktive financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe maturitet të përcaktuar, të cilat BQK-ja ka synimin e qartë dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim, dhe të cilat nuk janë përcaktuar si me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ose si të vlefshme për shitje. Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bonot e thesarit.

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Në raste të shitjes ose riklasifikimit përpara maturimit të një sasive të rëndësishme të letrave me vlerë që mbahen deri në maturim do të rezultonte në riklasifikimin e të gjithë letrave me vlerë që mbahen deri në maturim si të vlefshme për shitje, dhe do të pengonte BQK-në të klasifikonte letrat me vlerë për qëllime investimi si të mbajtura deri në maturim gjatë periudhës aktuale dhe gjatë dy viteve financiare pasuese.

i) Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë BQK-ja përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, dhe kostot e çmontimit dhe lëvizjes së pajisjeve dhe restaurimin e ambientit ku ato janë vendosur. Programe kompjuterike të blera që janë thelbësore për funksionimin e pajisjes përkatëse kapitalizohen si pjesë e asaj pajisje.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në BQK, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën e të ardhurave në momentin kur ndodhin.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

i) Prona dhe pajisjet (vazhdim)

iii. Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave me metodën lineare përgjatë jetëgjatësisë të secilës pjesë të pasurisë dhe pajisjeve.

Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasuese është si më poshtë:

	2008	2007
• Investimet në objektet me qira	20 vite	20 vite
• Pajisjet	5 vite	5 vite
• Kompjuterët	3 vite	3 vite
• Automjetet	5 vite	5 vite

Metoda e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur janë rivlerësuar në datën e raportimit.

j) Aktivitet e paprekshme

Programet kompjuterike të blera nga BQK-ja njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi programet kompjuterike kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin tek pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën e të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën ky program është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e programeve kompjuterike është 3 vjet (2007: 3 vjet).

k) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të BQK-së, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja ndërmjet çmimit neto të shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivitetin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është zbutur. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka pasur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

l) Depozitat dhe detyrimet tjera financiare

Depozitat janë burimet e financimit të BQK-së. Ato fillimisht janë të matura në vlerën e tregut duke shtuar kostot e transaksionit dhe maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën efektive të interesit përveç nëse BQK-ja zgjedh që t'i bartë detyrimet me vlerën e tregut në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

m) Të hyrat nga grantet

Grantet e qeverisë fillimisht njihen si të ardhura të shtyra kur ekziston një siguri e arsyeshme se ato do të merren dhe se BQK-ja do t'i përmbahet kushteve lidhur me grantin. Grantet që BQK-ja përfiton për shpenzimet njihen si fitim ose humbje në baza sistematike në të njëjtat periudha në të cilat njihen shpenzimet. Grantet që BQK-ja përfiton për koston e një pasurie njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë jetës së përdorimit të aktivit.

n) Pagat e financuara nga donatorët

Disa individë të angazhuar në BQK janë ekspertë ndërkombëtarë të caktuar nga organizata ndërkombëtare të cilat ofrojnë mbështetje financiare për BQK-në. Gjithashtu, këto organizata ndërkombëtare emërojnë ekspertë dhe këshilltarë afatshkurtër siç paraqitet nevoja. Mbështetja financiare e këtyre organizatave ndërkombëtare përfshin por nuk është e kufizuar në pagesën e pagave për pozita të tilla drejtuese dhe këshilluese.

Pasi kjo ndihmë u paguhet nga organizatat ndërkombëtare drejtpërdrejt të emëruarve, nivelet e pagesës nuk janë të njohura dhe as nuk janë të përfshira në pasqyrat financiare.

o) Provizionet

Provizionet njihen nëse, si rezultat i ngjarjeve që kanë ndodhur në të kaluarën, BQK-ja ka detyrime aktuale që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme, dhe është e mundshme që një dalje e parave apo të mirave ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke e skontuar rrjedhën e ardhshme të parasë me një normë para tatimit dhe që reflekton vlerësimin aktual të tregut të vlerës kohore të parasë dhe kur është e përshtatshme rrezikun e veçante ndaj detyrimeve.

Provizioni për kontrata me humbje njihet kur përfitimet e pritura nga kontrata janë më të vogla se kostoja e pashmangshme e realizimit të detyrimeve sipas kontratës. Provizioni matet me vlerën aktuale të koston së pritshme të përfundimit të kontratës dhe koston së pritshme neto të vazhdimin të kontratës, cilado është më e vogël. Përpara se të njihet një provizion BQK njeh çdo humbje nga rënia në vlerë e aktivitet të lidhur me atë kontratë.

p) Standarde dhe interpretime të reja ende të paadoptuara

Një sërë standardesh të reja, ndryshime apo interpretime të tyre ende nuk janë bërë efektive për vitin që mbyllet me 31 Dhjetor 2008, dhe nuk janë aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

- Rishikimi i SNRF 2 *Pagesa të Bazuara në Aksione - Të drejta pensioni dhe anulimet* (efektive që nga 1 Janari 2009) sqaron përkufizimin e konditave të kushtëzimit dhe prezanton konceptin e konditave jo-kushtëzuese. Konditat jo-kushtëzuese duhen reflektuar me vlerën e drejtë në datën e dhënies dhe dështimi në përmbushjen e konditave jo-kushtëzuese do të rezultojë përgjithësisht në trajtimin si anulim. Ndryshimet në SNRF 2 nuk janë relevante për veprimtaritë e BQK-së pasi BQK-ja nuk ka ndonjë plan kompensimi të pagesave të përbashkëta.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

p) Standardet dhe interpretime të reja ende të paadoptuara (vazhdim)

- SNRF 3 i rishikuar, *Kombinimet e Biznesit* (efektive për periudhat vjetore që fillojnë nga 1 korriku 2009) përfshin një sërë ndryshimesh domethënëse:
 - Të gjitha elementët e transferuara nga blerësi, njihen dhe maten me vlerën e drejtë në datën e blerjes, duke përfshire edhe elementë të kushtëzuar.
 - Ndryshime të mëvonshme në elementët e kushtëzuara do të njihen në pasqyrën e të ardhurave.
 - Kostot e transaksionit, përveç kostove të emetimit të aksioneve dhe instrumenteve të borxhit, do të njihen kur ndodhin.
 - Blerësi mund të zgjedhë të masë interesat e pakicës me vlerën e drejtë në datën e blerjes (emrin e mirë të plotë), ose interesin e tij proporcional në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të identifikuar të shitësit, mbi bazë transaksion pas transaksioni.

Banka nuk pret të ndikohet nga rishikimi i këtij standardi.

- SNRF 8 *Segmentet Operative* (efektive që nga 1 Janari 2009). Ky standard kërkon shpalosjen e segmenteve sipas komponentëve të entitetit që menaxhmenti i monitoron gjatë marrjes së vendimeve mbi çështjet operative. Segmentet operative janë komponentë të një entiteti për të cilat informacioni financiar është i disponueshëm që vlerësohet rregullisht nga “vendimmarrësi kryesor i aktiviteteve” në mënyrë që të vlerësojë performancën e çdo segmenti dhe t’iu shpërndajë atyre burime. BQK-ja ende nuk e ka përfunduar analizën e këtij standardi.
- SNK 1 i rishikuar *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (efektive që nga 1 Janari 2009) i cili paraqet termin “ të ardhura përmbledhëse totale”, që shfaqin ndryshime në kapital gjatë një periudhe të ndryshme nga transaksionet me ortakë në kapacitetin e tyre si ortakë. Pasqyra totale e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe përbërësit e të ardhurave të tjera përmbledhëse mund të paraqiten qoftë në një pasqyrë të vetme të të ardhurave përmbledhëse (duke kombinuar efektivisht pasqyrën e të ardhurave dhe të gjitha ndryshimet në kapital që nuk i përkasin pronarit në një pasqyrë të vetme), ose në dy pasqyra të ndryshme (një pasqyrë e veçantë e të ardhurave e ndjekur nga një pasqyrë për të ardhurat përmbledhëse). Aktualisht BQK-ja po vlerëson nëse duhet të paraqesë një pasqyrë të vetme të të ardhurave përmbledhëse apo dy pasqyra të ndryshme.
- SNK 23 i rishikuar *Kostot e Huamarrjes* (efektive nga 1 Janari 2009) heq mundësinë për të shpenzuar kostot e huamarrjes dhe kërkon kapitalizmin e kostove të huamarrjes që lidhen me aktivet e kualifikuara (ato që kërkojnë një kohë të gjatë për të qenë gati për qëllim përdorimi apo shitje). SNK 23 i rishikuar nuk është i aplikueshëm për operacionet e BQK-së sepse ajo nuk ka ndonjë aktiv të kualifikuar për të cilin kostot e huas të kapitalizohen.
- Rishikimi i SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale* (efektive për periudha vjetore që fillojnë pas 1 Janarit 2009) heq përkufizimin e “metodës së kostos” aktualisht i vendosur në SNK 27, dhe në vend të tij kërkon që të gjithë dividendët nga një filial, nga një shoqëri e kontrolluar bashkërisht ose nga një sipërmarrje, të njihen si e ardhur në pasqyrat financiare individuale të investitorit kur e drejta për marrjen e dividendit është vendosur. Për më tepër, rishikimi përfshin dhe udhëzime kur arkëtimi i të ardhurës nga dividendi konsiderohet të jetë një tregues për zhvlerësim. SNK 27 nuk është i aplikueshëm për pasqyrat financiare të BQK-së pasi ajo nuk ka interesa që preken nga rishikimet.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

p) Standardet dhe interpretime të reja ende të paadoptuara (vazhdim)

- Rishikimi i SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale (efektive për periudha vjetore duke filluar më ose pas 1 korrikut 2009)* zëvendëson termin interes minoritar me interesin jo të kontrollueshëm, i cili përcaktohet si kapital në një filial jo të atribueshme, në mënyrë direkte ose indirekte, me një shoqëri mëmë. Standardi i rishikuar gjithashtu ndryshon llogaritjen për interesin jo të kontrollueshëm, humbjen e kontrollit të një filiali, shpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhura të tjera përmbledhëse ndërmjet interesit të kontrollueshëm dhe atij jo të kontrollueshëm. Rishikimi i SNK 27 nuk lidhet me veprimtarinë e BQK-së meqenëse BQK nuk ka interes mbi ndonjë filial që mund të preket nga rishikimet në standard.
- Rishikimi i SNK 32 *Instrumentet Financiare* dhe SNK 1, *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*. Rishikimi prezanton një përjashtim të parimit, të aplikuar në SNK 32 për klasifikimin e instrumenteve si kapital; rishikimi lejon disa instrumente të kthimit të aksionit emetuar nga një njësi ekonomike që normalisht do të klasifikoheshin si detyrime të klasifikohen si kapital, atëherë dhe vetëm atëherë, kur ata përmbushin disa kushte të caktuara. Rishikimi nuk është i rëndësishëm për veprimtarinë e BQK-së duke qenë se ajo nuk ka emetuar në të shkuarën instrumente të kthyeshme që do të ndikoheshin nga ky rishikim.
- Rishikimi i SNK 39, *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja* sqaron aplikimin e parimeve ekzistuese që përcaktojnë nëse rreziqe specifike ose pjesë të flukseve monetare janë të pranueshëm të përcaktohen në një marrëdhënie mbrojtje. Në përcaktimin e një marrëdhënie mbrojtje, rreziqet ose pjesa e fluksit të parave duhet të identifikohen qartë dhe të maten në mënyrë të besueshme; sidoqoftë inflacioni nuk mund të përcaktohet, përveçse në rrethana të veçanta. Rishikimi i SNK 39 nuk është relevant për veprimtarinë e BQK-së duke qenë se ajo nuk e aplikon kontabilitetin mbrojtës.
- KIRFN 13 *Programet e Besnikërisë së Klientëve (efektive për periudha vjetore që fillojnë pas 1 korrikut 2008)* shpjegon se si njësitë ekonomike që dhurojnë pikë krediti për besnikërinë e klientëve që blejnë mallra apo shërbime duhet të kontabilizojnë për detyrimin që kanë për të siguruar mallra ose shërbime falas ose me ulje (dhurata) ndaj klientëve të cilët do t'i kërkojnë ato kredite. Njësi të tilla ekonomike duhet të shpërndajnë disa të ardhura nga shitjet fillestare tek pikët e kreditit dhe të njohin këto arkëtime si të ardhura vetëm kur i kanë përmbushur detyrimet e tyre ndaj klientëve. BQK-ja nuk pret efekte të mundshme të këtij interpretimi.
- KIRFN 15 *Marrëveshjet për Ndërtimin e Pasurive të Patundshme* sqaron se të ardhurat që rrjedhin nga marrëveshjet për ndërtimin e pasurive të patundshme njihen duke iu referuar fazës së realizimit të kontratës në rastet e mëposhtme:
 - Marrëveshja përmbush përcaktimin e një kontratë ndërtimi në përputhje me SNK 11.3;
 - Marrëveshja është vetëm për sigurimin e shërbimeve në përputhje me SNK 18 (p.sh., njësia ekonomike nuk kërkohet të furnizojë me materiale ndërtimi); dhe
 - Marrëveshja është për shitjen e mallrave por kriteri i njohjes së të ardhurave sipas SNK 18.14 përmbushet ndërsa ndërtimi vazhdon.

Në të gjitha rastet e tjera, e ardhura njihet kur të gjitha kriteret e njohjes së të ardhurave sipas SNK 18.14 janë përmbushur (p.sh. në përfundim të punimeve të ndërtimit ose në dorëzim). KIRFN 15 nuk është relevant për veprimtarinë e BQK-së meqë BQK-ja nuk siguron shërbime në ndërtimin e pasurive të patundshme dhe as nuk ndërton pasuri të paluajtshme për qëllime shitje.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

p) Standarde dhe interpretime të reja ende të paadoptuara (vazhdim)

- KIRFN 16 *Mbrojtjet e një Investimi Neto në një Njësi Ekonomike të Huaj (efektive për periudhat vjetore që fillojnë në/ose pas 1 tetorit 2008)* shpjegon llojin e ekspozimit që mund të mbrohet, në cilin grup duhet mbajtur zëri i mbrojtur, nëse metoda e konsolidimit e ndikon efektivitetin e mbrojtjes, forma që mund të marrë instrumenti mbrojtës, dhe cilat shuma janë riklasifikuar nga kapitali në pasqyrën e të ardhurave në momentin e mosnjohjes së njësisë ekonomike të huaj. KIRFN 16 nuk është relevant për veprimtarinë e BQK-së sepse ajo nuk ka ndonjë investim të tille.
- KIRFN 17 *Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve (efektive vijim për periudha që fillojnë në ose pas 15 korrikut 2009)* aplikohet për shpërndarjen jo-reciproke të aktiveve jo-monetare ndaj pronarëve në kapacitetin e tyre si pronarë. Në përputhje me interpretimin, një detyrim për të paguar dividend duhet të njihet kur dividendi është autorizuar siç duhet dhe duhet të matet me vlerën e drejtë të aktiveve që do të shpërndahen. Vlera kontabël e dividendit të pagueshëm duhet të vlerësohet në çdo datë raportimi, dhe ndryshim në vlerën kontabël njihen në kapital si korigjim i vlerës për shpërndarje. Kur dividendi i pagueshëm shlyhet, diferenca (nëse ka) midis vlerës kontabël të aktiveve të shpërndara dhe vlerës kontabël të dividendëve të pagueshëm do të njihet në pasqyrën e të ardhurave. Meqenëse interpretimi është i aplikueshëm vetëm prej datës së aplikimit, ai nuk do të ketë ndikim në pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme përpara datës së adoptimit të interpretimit. Për më shumë, meqenëse ai lidhet me dividendët e ardhshëm që do të jenë në zgjedhje të lirë të bordit të drejtorëve/aksionarëve, nuk është e mundur që të përcaktohet efekti i aplikimit në mënyrë paraprake.
- SNK 40 *Prona Investuese (efektive për periudha vjetore duke filluar nga 1 Janari 2009)*. SNK 40 është ndryshuar që të përfshijë pasuritë në ndërtim ose zhvillimin për përdorim të ardhshëm si pasuri investuese në përkufizimin e saj si “pronë investuese”. Kjo rezulton në ato pasuri që janë në përfshirje të SNK 40; më parë ka qenë e përfshirë nën SNK 16. SNK 40 nuk është i rëndësishëm për operacionet aktuale të BQK-se pasi ajo nuk ka prona investuese.

Bordi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit i ka bërë disa amendime standardeve ekzistuese. Datat efektive për këto amendime ndryshojnë sipas standardeve dhe shumica do të jenë të aplikueshme në pasqyrat financiare të BQK-së në vitin 2009. BQK-ja nuk pret ndonjë ndikim të madh të këtyre amendimeve mbi pasqyrat financiare.

q) Informacionet krahasuese

Informacionet krahasuese janë prezantuar në vazhdueshmëri duke përdorur politikat kontabël të BQK-së. Kur ka qenë e nevojshme, informatat krahasuese janë riklasifikuar për qëllime të krahasimit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar

a) Të Përgjithshme

Përdorimi i instrumenteve financiare e ekspozon BQK-në ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditit
- rreziku operacional
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Këto shënime paraqesin informacion lidhur me ekspozimin e BQK-së ndaj rreziqeve të mësipërme, për objektivat, politikave dhe procedurat për matjen dhe administrimin e tyre si dhe për administrimin e kapitalit të BQK-së. Shënime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.

Struktura e administrimit të rrezikut

Krijimi dhe monitorimi i strukturës së administrimit të rrezikut të BQK është përgjegjësi e Bordit drejtues të BQK-së. Manaxhmenti i BQK-së raporton rregullisht tek Bordi drejtues mbi veprimet e lidhura me administrimin e rrezikut. Komiteti ekzekutiv dhe Komitetit i investimeve janë të angazhuar në zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut të BQK-së. Këto politika implementohen më pas nga njësitë organizative respektive.

Politikat e administrimit të rrezikut të BQK-së janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e ndeshura nga BQK-ja, për të vendosur limite dhe kontrole të përshtatshme, dhe për të monitoruar rreziqet dhe zbatimin e limiteve të vendosura. Politikave dhe sistemet e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht në mënyrë që të reflektojnë ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Me anë të trajnimeve, standardeve dhe procedurave të administrimit, BQK-ja synon të zhvillojë një mjedis kontrolli konstruktiv dhe të disiplinuar, në të cilin të gjithë punonjësit të jenë të vetëdijshëm për funksionet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i auditimit të BQK-së është përgjegjës për monitorimin e pajtueshmërisë me politikave dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së strukturës së administrimit të rrezikut lidhur me rreziqet e ndeshura nga BQK-ja.

Komiteti i auditimit ndihmohet në kryerjen e detyrave të tij nga Departamenti i auditimit të brendshëm. Auditimi i brendshëm ndërmerr kontrole të procedurave të administrimit të rrezikut në mënyrë të rregullt dhe rastësore, rezultatet e të cilave, Inspektori i përgjithshëm ia raporton Komitetit të auditimit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

b) Rreziku i kreditit

Rreziku i kreditit është rreziku i humbjes për BQK-në nëse klienti ose një palë kontraktuese e instrumenteve financiare dështon të arrijë detyrimet kontraktuale të veta, dhe shkaktohet kryesisht nga investimet e BQK-së në letra me vlerë dhe depozitat në banka të tjera.

Administrimi i rrezikut të kreditit

i. Investimet dhe ekspozimi në banka të tjera

BQK-ja e kufizon ekspozimin e saj të rrezikut të kreditit duke investuar vetëm në letra me vlerë të emetuara nga qeveritë e vendeve të BE-së dhe duke pasur depozita pranë bankave të huaja, detyrimet afatshkurtra të cilave janë vlerësuar në një nga dy kategoritë më të larta nga agjencitë ndërkombëtare të njohura për vlerësimin e rrezikut të kreditit. Duke pasur vlerësimin më të lartë, menaxhmenti nuk pret ndonjë palë kontraktuese të dështojë në arritjen e detyrimeve të veta.

ii. Ekspozimi ndaj rrezikut të kreditit

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kreditit me 31 Dhjetor 2008 dhe 31 Dhjetor 2007 paraqitet nga vlera e mbartur e parasë së gatshme, llogari rrjedhëse me bankat jo rezidente, bono thesari dhe depozita me bankat jo rezidente. Për detaje mbi ekspozimin referojuni shënimeve 7, 8, 9 dhe 10.

Asnjë nga ekspozimet e BQK-së nuk është me vonesë ose me rënie në vlerë. Nuk ka ndryshime në politikat e administrimit të riskut nga vitet e kaluara. BQK-ja nuk mban asnjë kolateral apo ndonjë zmadhim krediti kundrejt ekspozimit ndaj rrezikut të kreditit.

c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që BQK-ja nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e lidhura me detyrimet financiare në kohën e duhur.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit

Qëndrimi i BQK-së në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet në kushte normale dhe të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj.

Politikat e monitorimit dhe adresimit të rrezikut të likuiditetit janë të vendosura nga Bordi drejtues.

BQK-ja administron rrezikun e likuiditetit duke investuar në depozita afatshkurtra me bankat jo-rezidente dhe duke mbajtur shumën të mjaftueshme të mjeteve monetare në valutat përkatëse. Politikat e administrimit të likuiditetit janë të vendosura në një mënyrë të tillë që edhe në kushte të pafavorshme BQK-ja të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e saj.

Pozicioni ditore i likuiditetit është i monitoruar dhe testimi i vështirësive të likuiditetit zvogëlohet nga mbulimi i skenarëve të ndryshëm për kushte normale dhe me të vështira të tregut. Të gjitha politikat dhe procedurat e likuiditetit janë pjesë e shikimit dhe aprovimit të menaxhmentit të BQK-së. Raportet ditore që mbulojnë pozicionin e likuiditetit të BQK-së i kalohen anëtareve të Komitetit të investimeve nga Departamenti i menaxhimit të mjeteve.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Teprica e maturiteteve kontraktuale të detyrimeve financiare

	Shënime	Vlera e mbetur	Më pak se 1 muaj	1-3 muaj	3 muaj deri 1 vit
31 Dhjetor 2008					
<i>Detyrimet jo-derivative</i>					
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	137,158	137,158	-	-
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	908,212	640,642	109,715	157,855
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	24,400	22,554	1,846	-
Detyrime të tjera të brendshme	17	1,978	1,978	-	-
		1,071,748	802,332	111,561	157,855
31 Dhjetor 2007					
<i>Detyrimet jo-derivative</i>					
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	113,554	113,554	-	-
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	856,730	856,730	-	-
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	48,381	37,825	-	10,556
Detyrime të tjera të brendshme	17	7,743	7,743	-	-
		1,026,408	1,015,852	-	10,556

Tabela e mësipërme tregon rrjedhjet e parasë të skontuara të detyrimeve financiare të BQK-së bazuar në mundësinë më të afërt të maturitetit të tyre kontraktual. Hyrjet / (daljet) nominale bruto të pasqyruara në tabelën e mëparshme janë rrjedhjet e parasë sipas maturitetit të paskontuar të detyrimeve financiare dhe angazhimeve.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe të Kosovës

Kriza ekonomike dhe financiare botërore ka rezultuar në, përveç të tjerave, në një nivel më të ulët të financimit të tregut kapital, nivel më të ulët të likuiditetit në sektorin bankar, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri në tregun e aksioneve. Zhvillimet e tjera të pafavorshme që rezultojnë nga kriza mund të kenë ndikim negativ në pozicionin financiar dhe likuid të BQK.

d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në balancën e kredisë të kredihënësit apo kredimarrësit) do të ndikojë në të ardhurat e BQK-së apo vlerën e instrumenteve financiare. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Administrimi i rrezikut të tregut

Operacionet e BQK-së i nënshtrohen rrezikut të luhatjes së normave të interesit në masën që aktivet interes-prurëse dhe detyrimet që sjellin interes maturohen ose riçmohen në kohë apo shuma të ndryshme. Aktivitet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë të ekspozuara ndaj rrezikut bazë, i cili është ndryshimi në karakteristikat e riçimit të treguesve të shumëllojshëm me norma të ndryshueshme.

Veprimtaritë e administrimit të rrezikut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi bazuar mbi nivelet e normave të interesit të tregut konsistente me strategjitë e veprimit të BQK-së.

Ekspozimi i BQK-së ndaj rrezikut të tregut lidhet vetëm me portofolet jo të tregtueshme.

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portofolet jo të tregtueshme

Rreziku kryesor ndaj të cilit portofolet jo të tregtueshme janë ekspozuar është rreziku i humbjes nga luhatja e flukseve të ardhshme të parasë apo e vlerave të drejta të instrumenteve financiare për shkak të një ndryshimi në normat e tregut. Rreziku i normës së interesit kryesisht administrohet duke monitoruar diferencat midis normave të interesit dhe duke pasur limite paraprakisht të miratuara për intervalet e riçimit. Komiteti i investimeve është organi që monitoron zbatimin e këtyre limiteve. Një përmbledhje e pozicionit të BQK-së lidhur me diferencën midis normave të interesit të portofoleve jo të tregtueshme paraqitet si më poshtë:

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të tregut - portfolet jo të tregtueshme (vazhdim)

	Shënime	Vlerat e mbeture	Me pak se 3 muaj	3-6 muaj	6-12 muaj
31 Dhjetor 2008					
Paraja e gatshme	7	39,674	39,674	-	-
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	10,403	10,403	-	-
Bono thesari	9	541,019	175,559	335,881	29,579
Depozita me banka jo-vendore	10	519,276	505,242	1,829	12,205
Totali		1,110,372	730,878	337,710	41,784
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	(137,158)	(137,158)	-	-
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	(908,212)	(750,357)	(157,855)	-
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	(24,400)	(24,400)	-	-
Detyrime të tjera të brendshme	17	(1,978)	(1,978)	-	-
Totali		(1,071,748)	(913,893)	(157,855)	-
Zbrazëtira		38,624	(183,015)	179,855	41,784
31 Dhjetor 2007					
Paraja e gatshme	7	63,817	63,817	-	-
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	1,946	1,946	-	-
Bono thesari	9	229,277	9,924	199,591	19,762
Depozita me banka jo-vendore	10	762,579	545,792	77,287	139,500
Totali		1,057,619	621,479	276,878	159,262
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	(113,554)	(113,554)	-	-
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	(856,730)	(856,730)	-	-
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	(48,381)	(43,225)	-	(5,156)
Detyrime të tjera të brendshme	17	(7,743)	(7,743)	-	-
Totali		(1,026,408)	(1,021,252)	-	(5,156)
Zbrazëtira		31,211	(399,773)	276,878	154,106

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Rreziku i përgjithshëm i normave të interesit jo të tregtueshme administrohet nga Departamenti i menaxhimit të mjeteve, i cili përdor investimet në letra me vlerë dhe depozitat në banka për të administruar rrezikun e përgjithshëm që lind nga aktivitetet jo tregtare të BQK-së.

Administrimi i rrezikut të normave të interesit kundrejt limitit të hendekut të normave të interesit, kompletohet duke vëzhguar ndjeshmërinë e aktiveve dhe detyrimeve të BQK-së ndaj skenarëve të ndryshëm standardë dhe jo-standardë të normave të interesit. Skenarët standardë të cilët vlerësohen në mënyrë periodike, përfshijnë një rënie ose ngritje paralele në të gjitha kurbat e kthimit, prej 100 pikësh baze (pb). Një analizë e ndjeshmërisë së BQK-së ndaj një rritje ose rënie të normave të interesit të tregut (duke supozuar që nuk ka lëvizje asimetrike të kurbave të kthimit si dhe një gjendje të qëndrueshme të bilancit) është si vijon:

2008	Skenarë deri në 1 Vit		Skenarë mbi 1 Vit	
	100 pb	100 pb	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	95	(95)	-	-
2007	Skenarë deri në 1 Vit		Skenarë mbi 1 Vit	
	100 pb	100 pb	100 pb	100 pb
	Rritje	Rënie	Rritje	Rënie
Efekti i parashikuar në fitim (humbje)	268	(268)	-	-

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/ monedhës të portofoleve jo të tregtueshme

BQK-ja është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit përmes transaksioneve me valutë të huaj. BQK-ja siguron se ekspozimi neto mbahet në një nivel të pranueshëm duke shitur dhe blerë kur është e nevojshme, me kursin e menjëhershëm (spot) për të rregulluar ç'balancimet afatshkurtra. Ekspozimi i BQK ndaj rrezikut të kursit të këmbimit është si vijon:

	EUR	USD	Totali
31 Dhjetor 2008			
Aktivitet			
Paraja e gatshme	39,674	-	39,674
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	10,403	-	10,403
Bono thesari	541,019	-	541,019
Depozita me banka jo-vendore	519,276	-	519,276
Aktive të tjera	406	-	406
Totali	1,110,778	-	1,110,778
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	137,158	-	137,158
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	908,212	-	908,212
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	24,400	-	24,400
Detyrime të tjera të brendshme	1,978	-	1,978
Totali	1,071,748	-	1,071,748
Pozicioni neto për monedhë	39,030	-	39,030

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

(d) Rreziku i tregut (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rreziqeve të tjera të tregut/ monedhës të portofoleve jo të tregtueshme (vazhdim):

	EUR	USD	Totali
31 Dhjetor 2007			
Aktivet			
Paraja e gatshme	63,805	12	63,817
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	1,946	-	1,946
Bono thesari	229,277	-	229,277
Depozita me banka jo-vendore	762,579	-	762,579
Aktive të tjera	295	-	295
Totali	1,057,902	12	1,057,914
Detyrimet			
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	113,554	-	113,554
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	856,730	-	856,730
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	48,381	-	48,381
Detyrime të tjera të brendshme	7,743	-	7,743
Totali	1,026,408	-	1,026,408
Pozicioni neto për monedhë	31,494	12	31,506

(e) Rreziku operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjeve direkte apo indirekte që shkaktohen nga një shumëllojshmëri shkaqesh të lidhura me proceset e BKQ-së, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën si dhe faktorëve të tjerë të jashtëm përpos rrezikut të kreditit, tregut dhe likuiditetit siç janë kërkesat ligjore dhe rregullatore si dhe standardet e pranuar gjerësisht të sjelljes në korporatë. Rreziku operacional rrjedh nga të gjitha operacionet e BQK-së dhe prek të gjitha njësitë organizative. Objektivi i BQK-së është të menaxhojë rrezikun operacional si dhe të balancojë evitimin e humbjeve financiare dhe dëmtimin e emrit të BQK-së me administrimin efektiv të kostove.

Përgjegjësia kryesore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për monitorimin e rrezikut operacional i përket stafit manaxhues të çdo njësie organizative. Kjo përgjegjësi shoqërohet me respektimin e të gjitha standardeve të BQK-së për menaxhimin e rrezikut operacional në fushat e mëposhtme:

- kërkesat për ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive, duke përfshirë këtu edhe autorizimin e pavarur të transaksioneve;
- kërkesat për rakordimin dhe monitorimin e transaksioneve;
- përshtatshmëria me kërkesat rregullatore dhe ligjore;
- dokumentimi i kontrolleve dhe procedurave;
- kërkesat për vlerësimin periodik të rrezikut operacional dhe përshtatshmërisë së kontrolleve dhe procedurave për administrimin e këtij rreziku;
- kërkesat për raportimin e humbjeve operative dhe propozimit të veprimeve korrigjuese;
- zhvillimin e planeve të angazhimit;
- trajnimit dhe zhvillimit profesional;
- standardet etike dhe të sjelljes;
- zvogëlimin të rrezikut, duke përfshirë dhe sigurimin kur kjo është efektive.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Manaxhimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

e) Rreziku operacional (vazhdim)

Përshtatshmëria me standardet e BQK-së mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Auditimi i brendshëm. Gjetjet e kontrolleve të Auditimit të brendshëm diskutohen me manaxherët e njësisë organizative me të cilat ato janë të lidhura dhe konkluzionet i dërgohen Komitetit të auditimit dhe menaxhmentit të BQK-së.

f) Administrimi i Kapitalit

Kapitali rregullator

Ligji nr. 03/L-074 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, aprovuar me datë 5 qershor 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, përcakton kërkesat e kapitalit të BQK-së. Sipas këtij ligji, kapitali i autorizuar i BQK-së është 30 milionë euro. Sipas dispozitave të ligjit, llogaritë e kapitalit dhe rezervës së përgjithshme duhet të jenë të paktën pesë për qind e shumës së agreguar të balancave kreditore në të gjithë llogaritë e mbajtura në librat e BQK-së siç paraqitet në pasqyrat financiare të BQK-së për çdo vit financiar. Kapitali mund të rritet me vendim të Bordit drejtues të BQK-së dhe aprovim nga Qeveria. Kapitali i BQK-së nuk është subjekt i asnjë lloj barre.

Asnjë reduktim i kapitalit nuk mund të realizohet, përveç rasteve të shpalljes së legjislacionit të ri nga Kuvendi. Kurdo që:

- në bilancin mujor pro forma të BQK-së, vlera e aktiveve bie nën shumën e detyrimeve dhe kapitalit të autorizuar të paprekur; ose
- fitimi neto i BQK-së për cilindo vit financiar është i pamjaftueshëm për rritjen e kapitalit dhe rezervës së përgjithshme të BQK-së në një nivel të barabartë me pesë për qind të shumës së agreguar të balancave kreditore të të gjithë llogarive në librat e BQK-së të paraqitura në pasqyrat financiare të BQK-së për atë vit financiar;

Ministria e Ekonomisë dhe Financave duhet që brenda një muaji nga publikimi i bilancit të tillë financiar, të bëjë një kontribut kapitali në vlerën e deficitit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

4. Manaxhimi i Rrezikut Financiar (vazhdim)

f) Manaxhimi i kapitalit (vazhdim)

Kapitali rregullator (vazhdim)

Kapitali rregullator i BQK-së sipas 31 Dhjetorit është si më poshtë:

	Shënime	2008	2007
Kapitali dhe Rezerva e Përgjithshme			
Kapitali	18	30,000	20,000
Rezerva të përgjithshme	19	3,736	4,590
Fitime të mbajtura	19	7,467	9,146
Totali		41,203	33,736

Llogaritë e paraqitura në librat e BQK-së më 31

Dhjetor

Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	137,158	113,554
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	908,212	856,730
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	24,400	48,381
Detyrime të tjera të brendshme	17	1,695	1,612
Totali		1,071,465	1,020,277

Kapitali/ Llogaritë e paraqitura në librat e BQK-së më 31 Dhjetor

Përqindja sipas ligjit

3.85%	3.31%
5%	5%

‘Detyrime të tjera të brendshme’ i paraqitur në tabelën e mësipërme nuk përfshin balancat si ‘e ardhura e shtyrë e granteve’ ‘kreditorë të ndryshëm dhe detyrime të shtyra’ si dhe ‘llogaritë në transit’.

Sipas Ligjit nr. 03/L-074, e ardhura neto apo humbja neto e BQK-së llogaritet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK).

E ardhura neto alokohet çdo vit në një llogari të rezervave të përgjithshme derisa totali i llogarive të kapitalit dhe rezervave të barazojë pesë për qind të shumës së agreguar të balancave kreditorë të të gjithë llogarive në librat e BQK-së të paraqitura në pasqyrat financiare të BQK-së për atë vit financiar.

Çdo balancë e të ardhurave neto, duhet t’i transferohet Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave si e ardhur në buxhet. Nëse ka një humbje neto, kjo duhet t’i zbritet rezervave të përgjithshme apo kapitalit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

5. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Menaxhmenti i BQK-së diskuton me Bordin drejtues zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të BQK-së, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencë dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet të jenë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 4).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Fonde të lejuara për humbje nga kreditë

Aktivitet e regjistruara me kosto të amortizuar vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitet, në bazë të politikave të përshkruara në 3(f)(vi).

Përbërësi specifik në totalin e provigjioneve për rënie në vlerë të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave menaxhmenti i BQK-së gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavarur nga menaxhmenti.

Gjykime kritike kontabël në aplikimin e politikave kontabël të BQK-së

Gjykimet kritike kontabël të kryera gjatë aplikimit të politikave kontabël të BQK-së përfshijnë:

Klasifikimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare

Politikat kontabël të BQK-së krijojnë mundësinë që aktivitet dhe detyrimet të vendosen që në fillim në kategori të ndryshme kontabël sipas rrethanave të caktuara.

Në klasifikimin e aktiveve si të mbajtura deri në maturim, BQK-ja ka treguar se ka qëllimin pozitiv dhe aftësinë për ti mbajtur aktivitet deri në datën e maturimit, siç kërkohet nga politikat kontabël 3 (h)(j).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

6. Aktivitet dhe detyrimet financiare

Klasifikimet kontabël dhe vlerat e drejta

Tabela më poshtë tregon klasifikimin e secilës klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare, dhe vlerat e drejta të tyre:

<i>Në mijë EUR</i>	Shënime	Hua dhe të arkëtueshme	Të mbajtura deri në maturim	Të tjera me kosto të amortizuar	Vlera në bilanc	Vlera e drejtë
31 Dhjetor 2008						
Paraja e gatshme	7	39,674	-	-	39,674	39,674
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	10,403	-	-	10,403	10,403
Bono thesari	9	-	541,019	-	541,019	541,759
Depozita me banka jo-vendore	10	519,276	-	-	519,276	519,276
		569,353	541,019	-	1,110,372	1,111,112
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	-	-	137,158	137,158	137,158
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	-	-	908,212	908,212	908,212
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	-	-	24,400	24,400	24,400
Detyrime të tjera të brendshme	17	-	-	1,978	1,978	1,978
		-	-	1,071,748	1,071,748	1,071,748
31 Dhjetor 2007						
Paraja e gatshme	7	63,817	-	-	63,817	63,817
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	1,946	-	-	1,946	1,946
Bono thesari	9	-	229,277	-	229,277	229,315
Depozita me banka jo-vendore	10	762,579	-	-	762,579	762,579
		828,342	229,277	-	1,057,619	1,057,657
Detyrimet ndaj bankave të brendshme	14	-	-	113,554	113,554	113,554
Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse	15	-	-	856,730	856,730	856,730
Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike	16	-	-	48,381	48,381	48,381
Detyrime të tjera të brendshme	17	-	-	7,743	7,743	7,743
		-	-	1,026,408	1,026,408	1,026,408

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

7. Paraja e gatshme

Paraja e gatshme është në monedhat e mëposhtme:

	2008	2007
EUR	39,674	63,805
USD	-	12
Totali	39,674	63,817

8. Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore

Këto llogari janë mbajtur në këto banka:

	2008	2007
Deutsche Bundesbank	9,436	1,343
Raiffeisen Zentralbank	161	255
Svenska Handelsbanken	130	197
Dresdner Bank	-	112
Commerzbank	676	39
Totali	10,403	1,946

9. Bono thesari

Bonot e thesarit janë letra borxhi me vlerë të lëshuara nga qeveritë e vendeve të BE-së. Ato kanë maturitete deri në dymbëdhjetë muaj dhe janë për tu mbajtur deri në maturim. Të gjitha bonot janë të paraqitura në EUR dhe kanë normë efektive të interesit duke filluar nga 1.83% deri 4.37% (2007: 3.83% deri 4.18%)

Bonot e thesarit janë emetuar nga qeveritë e shteteve të BE-së, siç vijon:

	2008	2007
Gjermani	69,537	54,572
Francë	84,929	39,627
Finlandë	-	35,786
Holandë	54,904	-
Itali	67,128	24,738
Portugali	43,836	19,890
Belgjikë	220,685	54,664
Totali	541,019	229,277

Banka investon ne bono thesari me një minimum vlerësimi kreditor prej AA (vlerësimi Standard & Poor's).

Bonot e thesarit më 31 Dhjetor 2008 përfshijnë një shumë prej EUR 267,893 mijë që përfaqëson bono thesari të blera nga BQK-ja për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ("Ministria"). Bazuar në një Memorandum Mirëkuptimi me Ministrinë, BQK-ja do luajë rolin e një menaxheri të investimeve për fondet e Ministrisë. Palët janë në proces të kërimit të qartësisë mbi aranzhimin, përfshirë çështje kontabël si ajo nëse investimet janë aktive apo detyrime të BQK-së, nëse ato duhen njohur në bilancin e saj dhe nëse BQK-ja është e ekspozuar ndaj çfarëdo rreziku kreditor lidhur me këto investime.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

10. Depozita me banka jo-vendore

Llogaritë e depozitave me bankat jo-vendore përbëhen nga:

	2008	2007
Depozita		
Raiffeisen Zentralbank	29,700	103,800
Svenska Handelsbanken	166,200	90,800
HBOS Treasury Service	-	70,268
ING Bank	21,735	107,330
Dresdner Bank	-	92,600
Deutsche Bundesbank	50,300	101,800
KBC	41,571	66,488
Rabobank	96,579	32,754
Danske Bank	46,813	20,016
Commerzbank	65,700	71,200
	518,598	757,056
Interes i përlogaritur për depozita		
Raiffeisen Zentralbank	153	426
Svenska Handelsbanken	92	971
HBOS Treasury Service	-	825
ING Bank	2	901
Dresdner Bank	-	701
Deutsche Bundesbank	95	477
KBC	5	540
Rabobank	319	214
Danske Bank	6	337
Commerzbank	6	131
	678	5,523
Totali	519,276	762,579

Depozitat e vendosura në banka jo-vendore janë në EUR dhe fitojnë interes me normë efektive duke filluar nga 1.41% deri 5.00% (2007: 3.00% deri 4.80%) dhe kanë maturitetet nga 1 deri në 355 ditë (2007: nga 1 deri 368 ditë).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

11. Prona dhe pajisjet

Prona dhe pajisjet përbëhen nga sa vijon:

	Investimet ne objektet me qira	Pajisjet	Kompjuterë	Automjete	Pasuria në ndërtim	Totali
Kosto						
Më 1 janar 2007		469	351	87	1,041	1,948
Shtesa	-	68	94	32	1,005	1,199
Transferime	1,279	767	-	-	(2,046)	-
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(33)	-	-	-	(33)
Më 31 Dhjetor 2007	1,279	1,271	445	119	-	3,114
Gjendja më 1 Janar 2008	1,279	1,271	445	119	-	3,114
Shtesa	-	188	169	-	-	357
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	(1)	(12)	-	(13)
Më 31 Dhjetor 2007	1,279	1,459	613	107	-	3,458
Zhvlerësimi						
Me 1 Janar 2007	-	405	229	52	-	686
Zhvlerësimi i periudhës	64	200	74	15	-	353
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	(33)	-	-	-	(33)
Më 31 Dhjetor 2007	64	572	303	67	-	1,006
Më 1 Janar 2008	64	572	303	67	-	1,006
Zhvlerësimi i periudhës	64	203	94	17	-	378
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	(1)	(12)	-	(13)
Me 31 Dhjetor 2008	128	775	396	72	-	1,371
Vlera neto						
Më 1 Janar 2007	-	64	122	35	1,041	1,262
Më 31 Dhjetor 2007	1,215	699	142	52	-	2,108
Më 31 Dhjetor 2008	1,151	684	217	35	-	2,087

Aktivitet në ndërtim lidhen me përmirësime sigurimi të zyrave të BQK-së. Sipas nenit tre të Ligjit Nr. 03/L-074, BQK, për qëllimet e veta të biznesit, shfrytëzon dhe administron pronën dhe pajisjet, duke përfshirë këtu pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme, që ndodhen në rrugën Garibaldi numër 33, Prishtinë, Kosovë.

Nuk ka aktive të bllokuara si kolateral më 31 Dhjetor 2008 (2007: asnjë).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

12. Aktivet e paprekshme

Aktivët e paprekshme përbëhen nga:

	Softuerë ne zhvillim	Softuerë	Totali
Kosto	-		
Gjendja më 1 Janar 2007	-	945	945
Shtesa	-	72	72
Gjendja më 31 Dhjetor 2007	-	1,017	1,017
Gjendja më 1 Janar 2008	-	1,017	1,017
Shtesa	25	19	44
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	25	1,036	1,061
Amortizimi			
Gjendja më 1 Janar 2007	-	801	801
Amortizimi për periudhën	-	94	94
Gjendja më 31 Dhjetor 2007	-	895	895
Gjendja më 1 Janar 2008	-	895	895
Amortizimi për periudhën	-	81	80
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	-	976	975
Vlera neto			
Gjendja më 1 Janar 2007	-	144	144
Gjendja më 31 Dhjetor 2007	-	122	122
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	25	60	86

13. Aktive të tjera

Aktive të tjera përbëhen nga:

	2008	2007
Të hyrat akruale nga komisionet	357	264
Llogari të arkëtueshme dhe parapagime	49	31
Totali	406	295

Të hyrat akruale nga komisionet paraqesin vlerësimet për komisionet nga ripërtëritja e licencave nga institucionet financiare për tremujorin e fundit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

14. Detyrimet ndaj bankave të brendshme

Sipas rregullës XVII të BQK-së, bankat komerciale që operojnë në Kosovë janë të obliguara të mbajnë rezerva të likuiditetit në shumën prej 10% depozitave të kualifikuara të klientëve të tyre. Së paku gjysma e kësaj rezerve duhet të mbahet në llogari në BQK-së.

BQK paguan interes për mjetet e bankave komerciale që mbahen në llogari te ajo deri në shumën e barabartë me përpjesëtimin e rezervave minimale të obliguara prej 10%. Norma e interesit më 31 Dhjetor 2008 ishte 1.25% (më 31 Dhjetor 2007 ishte 3%).

	2008	2007
ProCredit Bank	25,117	21,889
Raiffeisen Bank	23,875	19,219
NLB Prishtina	7,699	6,865
Banka Komerciale	1,132	-
Banka Ekonomike	2,191	1,927
Banka për Biznes	2,025	1,460
Banka Kombëtare Tregtare	352	124
Turkish Economic Bank	1,381	-
Totali i rezervës së kërkuar të likuiditetit	63,772	51,484
ProCredit Bank	34,242	12,551
Raiffeisen Bank	12,438	18,854
NLB Prishtina	7,023	15,243
Banka Ekonomike	1,520	1,701
Banka për Biznes	10,164	5,869
Banka Kreditore e Prishtinës	226	72
Banka Kombëtare Tregtare	4,852	5,731
Banka Komerciale	1,179	2,029
Turkish Economic Bank	1,742	20
Totali i llogarive rrjedhëse	73,386	62,070
Totali	137,158	113,554

15. Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse

Detyrimet ndaj institucioneve lokale qeverisëse përfshijnë llogaritë siç vijon:

	2008	2007
Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit	403,610	405,895
Ministria e Ekonomisë dhe Financave	498,425	447,469
Institucione të tjera qeveritare	6,177	3,342
UNMIK-u	-	24
Totali	908,212	856,730

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 Dhjetor 2008 ishte 1.25% (më 31 Dhjetor 2007 ishte 3%).

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

16. Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike

Detyrimet ndaj entiteteve tregtare dhe publike përfshijnë llogaritë dhe depozitat me afat siç vijon:

	2008	2007
Llogaritë rrjedhëse		
Kompanitë e sigurimit	15,394	14,866
Korporatat shërbyese publike	1,535	20,986
Fondet pensionale	67	1,916
Të tjera	2	2
	16,998	37,770
Depozitat me afat		
Kompanitë e sigurimit	7,402	5,204
Korporatat shërbyese publike	-	5,407
Fondet pensionale	-	-
	7,402	10,611
Totali	24,400	48,381

Norma efektive e interesit për llogaritë rrjedhëse më 31 Dhjetor 2008 ishte 1.25% (31 Dhjetor 2007: 3%), ndërsa për depozita me afat kjo normë ishte prej 3.95% deri 4.45% (31 Dhjetor 2007: 1.6% - 4.05%)

17. Detyrime të tjera të brendshme

	2008	2007
Detyrime ndaj Qeverisë së Kosovës	1,162	1,094
Të hyrat e shtyra nga grantet	-	49
Detyrimet ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës	495	480
Kreditorët e vegjël dhe akrualet	283	178
Llogaria e përkohshme	-	5,904
Detyrime të tjera vendore	38	38
Totali	1,978	7,743

Balanca e depozitave të Qeverisë së Kosovës me 31 Dhjetor 2008 që i referohej shumës EUR 1,162 (2007: EUR 1,094) përbëhet nga qiratë e marra prej ndërtesave publike dhe nga gjobot për institucionet financiare. Përfituesi i tyre nuk ishte përcaktuar ende në datën e miratimit të pasqyrave financiare.

Detyrimet ndaj ish Bankës Popullore të Kosovës përbëhen nga sa vijon. Që prej themelimit BQK ka trashëguar disa shuma të parasë së gatshme në valuta të ndryshme nga ish Banka Popullore e Kosovës. Gjithashtu, në këtë shumë është i përfshirë edhe interesi i akumuluar që prej 5 Janarit 2004. Paraja e gatshme së pari është konvertuar në DEM 872 mijë me 22 Dhjetor 2000, dhe me pas është transferuar në llogaritë e BQK-së në Commerzbank AG Frankfurt. Balanca e llogarisë me 1 Janar 2002 është konvertuar në EUR 446 mijë. Balanca e kësaj llogarie me 31 Dhjetor 2008 dhe 2007 përfshin shumën në fjalë bashkë me interesin e akumuluar deri në ato data.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

17. Detyrime të tjera të brendshme (vazhdim)

Llogaria transitore me shumë prej EUR 5,904 mijë në vitin 2007 lidhet me një transfer për Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Veprimi u krye më 2 Janar 2008.

Lëvizjet në të hyrat nga grantet ishin si vijon:

	Autoriteti Qendror Fiskal/Ministria e Ekonomisë dhe Financave/BE	Banka Botërore /Të tjera	Totali
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 Janar 2007	149	152	301
Grante të reja gjatë vitit	-	-	-
Të hyrat nga grantet për vitin	(149)	(103)	(252)
Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 Dhjetor 2007	-	49	49
Të hyrat e shtyra nga grantet më 1 Janar 2008	-	49	49
Grante të reja gjatë vitit	36	-	36
Të hyrat nga grantet për vitin	(36)	(49)	(85)
Të hyrat e shtyra nga grantet më 31 Dhjetor 2008	-	-	-

18. Kapitali

Bazuar në Rregulloren e UNMIK nr. 1999/20, kapitali fillestar i BQK-së ishte DEM 5,000 mijë (EUR 2,556 mijë) dhe u deponua nga Autoriteti Qendror Fiskal me 31 Mars 2000. Me 8 Qershor 2004, bazuar në vendimin e Zëvendësit të të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara (Shtylla e IV e UNMIK), kapitali qe rritur nga EUR 2,556 mijë në EUR 10,000 mijë.

Sipas Rregullores se UNMIK nr 2006/47, më 15 qershor 2007, pasi që është miratuar nga Bordi drejtues, EUR 10,000 janë bartur nga rezervat në kapitalin e BQK-së. Sipas Ligjit nr 03/L-074, më 29 korrik 2008, Bordi miratoi transferimin edhe të një shume prej EUR 10,000 mijë, prej rezervës në kapitalin primar të BQK-së.

BQK-ja i raporton direkt Kuvendit të Republikës së Kosovës. Kapitali i BQK-së nuk është subjekt i ndonjë kufizimi.

19. Rezerva të përgjithshme

Rezervat e përgjithshme u krijuan në pajtueshmëri më Rregulloren e UNMIK rr 1999/20. Më vonë, qenë adresuar me rregulloret të tjera zëvendësuese të UNMIK-ut.

Tani, niveli i rezervave të përgjithshme rregullohet me Ligjin nr 03/L-074. Fitimi neto i çdo viti financiar, në pajtueshmëri më ligjin dhe me miratimin e Bordit drejtues, është transferuar në rezerva të përgjithshme ose te Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

20. Të hyra nga interesi neto

Të hyra nga interesi neto përbëhen si më poshtë:

	2008	2007
Të hyra nga interesi		
Nga depozitat me afat (afatizuara)	33,290	25,447
Nga bonot e thesarit	9,467	8,639
Nga llogarite rrjedhëse	84	189
	42,841	34,275
Shpenzimet e interesit		
Në llogaritë rrjedhëse të entiteteve jo-bankare	22,011	20,477
Në llogaritë rrjedhëse të kualifikuara të bankave	3,066	1,624
Në depozitat me kushte fikse (të afatizuara)	8,986	2,270
	34,063	24,371
Të hyra nga interesi neto	8,778	9,904

21. Të hyra nga tarifatat dhe komisionet neto

Të hyra nga tarifatat dhe komisionet përbëhen si më poshtë:

	2008	2007
Të hyra nga tarifatat dhe komisionet		
Nga depozitime parash	124	124
Nga transferat e jashtëm (hyrës)	96	197
Nga transferat e jashtëm (dalës)	356	283
Nga sistemi kliringut ndër-bankar	145	122
Nga sistemi i regjistrit të krediteve	67	-
Tarifatat e tjera	96	17
	884	743
Shpenzimet nga tarifatat dhe komisionet		
Për transport parash	182	197
Për veprime me banka korrespondente	33	29
	215	226
Të hyra nga tarifatat dhe komisionet neto	669	517

22. Të hyrat nga grantet

Të hyrat nga grantet përbëhen nga:

	2008	2007
Banka Botërore	49	275
BE	36	178
Totali	85	453

23. Të hyrat e tjera nga aktivitetet operuese

Të ardhurat tjera operative përfshijnë kryesisht tarifa të ngarkuara ndaj institucioneve financiare në Kosovë si pjesë e lëshimit dhe ripërtëritjes së licencave, po ashtu edhe tarifa tjera të detyrueshme që kanë të bëjnë me aktivitetet e tyre.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

24. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit përbëhen nga:

	2008	2007
Pagat dhe rrogat	1,219	999
Shpenzimet e sigurimit social dhe shëndetësor	326	259
Trajnimet e stafit	132	87
Kompensimi i Bordit drejtues	58	37
Të tjera	36	30
Totali	1,771	1,412

Numri i punëtoreve në BQK me 31 Dhjetor 2008 është 158 (31 Dhjetor 2007: 141).

25. Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

Shpenzime të përgjithshme dhe administrative

	2008	2007
Shpenzimet e sigurimit	234	191
Riparime dhe mirëmbajtje	69	67
Mirëmbajtja e programit (softuerit)	108	93
Shpenzimet e komunikimit (telefon, telex, dhe internet)	79	62
Shërbime komunale	70	80
Shpenzimet e auditimit dhe këshillimit	23	20
Shpenzimet sigurisë dhe transportit të parave	44	46
Udhëtime dhe transport	68	75
Shpenzimet e operimit të veturave	25	20
Materiale zyre dhe artikuj shkrimi	22	18
Shpenzime për ushqim dhe reprezentacion	12	10
Shpenzimet e kompjuterëve dhe të tjera konsumuese	58	38
Shpenzimet e publikimit dhe shpenzimet e literaturës	51	29
Të tjera	60	74
Totali	923	823

26. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përbëhen nga:

	Shënime	2008	2007
Paraja e gatshme	7	39,674	63,817
Llogaritë rrjedhëse me banka jo-vendore	8	10,403	1,946
Bono thesari me maturim deri tre muaj		175,559	9,924
Depozita me banka jo-vendore me maturim deri tre muaj		505,242	545,792
Totali		730,878	621,479

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Shënime mbi pasqyrat financiare

(Në mijë EUR, nëse nuk shprehet ndryshe)

27. Angazhime dhe garanci

Ligjore

BQK-ja është e përfshirë në procedura ligjore rutinore që janë në kursin e zakonshëm të veprimtarisë. Është mendimi i menaxhmentit se rezultati përfundimtar i këtyre padive nuk do të ketë një efekt material mbi rezultatet e BQK-së.

Angazhimet që lidhen me kreditë

Më 31 Dhjetor 2008, BQK-ja nuk kishte angazhime për të bërë depozita (31 Dhjetor 2007 EUR 28,191 mijë).

Angazhimet e tjera

Angazhimet e tjera përbëhen si vijon:

2008

	Jo më vonë se 1 vit
Blerje automjetesh	144
Blerje e aplikacioneve kompjuterike	50
Riparime - Instalim i sistemit të zërimit	42
Totali	236

2007

	Jo më vonë se 1 vit
Freskimi i sigurisë së lokaleve(puna dhe konsulenca)	92
Blerje pajisjesh	48
Totali	140

28. Palët e lidhura

Palë të lidhura janë drejtuesit (menaxhmenti) dhe anëtarët e Bordit drejtues. Kompensimet e tyre përbëhen nga:

	2008	2007
Kompensimi i Bordit drejtues	58	37
Kompensimi i drejtuesve	100	65
Totali	158	102

29. Ngjarjet pas datës së mbylljes së bilancit

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas bilancit që mund të ketë nevojë për rregullime ose shënime shpjeguese në këto pasqyra financiare.